

**NJOFTIM MBI DATAT, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT, KONKURIMIT
DHE REGJISTRIMIT PËR PRANIM, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
PROGRAMI BACHELOR**



Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, njofton të gjithë të interesuarit se ka hapur regjistrimet për ciklin e parë të studimeve, për vitin akademik 2022-2023 në tre degët e saj:

- ***Shkenca Ushtarake***
 - ***Teknologji Informacioni ne fushën e Mbrojtjes***
 - ***Navigim dhe Komandim Detar ne Fushën e Mbrojtjes***

Me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, të cilët do të ndjekin studimet në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Ushtarake në një nga tre programet e Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeni mëposhtë gjithë informacionin e nevojshëm:

DATAT E APLIKIMIT, KONKURIMIT TË APLIKANTËVE/KANDIDATËVE DHE REGJISTRIMIT TË FITUESVE (RAUNDI I PARË)

- **29 Korrik -03 Gusht 2022** aplikimi në www.ualbania.al
- **08 -11 Gusht 2022 (09:00 -16:00)** Regjistrimi i aplikantëve për konkurim
- **11 Gusht 2022** Shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurim
- **15 - 20 Gusht 2022** Zhvillimi i konkursit (testimeve)
 - ✓ *Ekzaminimi mjekësor*
 - ✓ *Testimi fizik*
 - ✓ *Testimi intelektual*
 - ✓ *Testimi psikologjik*
- **30 Gusht 2022** Shpallja e kandidatëve fitues
- **01 Shtator 2022** Ankimimi
- **02 -15 Shtator 2022** Regjistrimi i kandidatëve fitues të raundit të parë

- **16 -17 Shtator 2022** Ç`rregjistrimi i aplikantëve fitues

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT PËR KONKURIM (RAUNDI I PARË)

- Dokument identifikimi (dokument origjinal dhe një fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës);
- Kërkesë me shkrim e aplikantit, për ndjekjen e studimeve;
- Certifikatë familjare, copë 1 (një) ;
- Fotografi për dokument në përmasat (4 x 6), copë 2 (dy); Fotokopje e noterizuar e diplomës së maturës shtetërore ose e dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA;
- Raport mjekësor mbi aftësinë shëndetësore për studime, lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të aplikantit, shoqëruar edhe me një raport shpjegues në të cilin të deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, (nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamezën e tij personale, si dhe që nuk është përdorues i lëndëve narkotike);
- Fletë analiza mjeksore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, për agjentë infektivë (Hepatit B; Hepatit C; Hepatit D; HIV/AIDS, sifiliz); grupin e gjakut, si dhe testet për lëndë narkotike lëshuar nga laboratorë të çertifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Deklaratë e aplikantit, (Shtojca 1);
- Formular i të dhënave personale të aplikantit (Aneksi A), mbi të dhënat personale të aplikantit;
- Formular vetëdeklarimi (Aneksi B), mbi të dhënat personale të aplikantit në lidhje me statusin juridik;
- Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për oficer aktiv (Aneksi C);
- Mandat pagesë e tarifës së konkurimit në vlerën 2 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të parë Bachelor dhe në vlerën 4 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të dytë Bachelor;

Për sa më sipër sqarojmë se, formularët “Shtojca 1”; “Aneksi A”, “Aneksi B”, “Aneksi C”, si dhe “Fatura për pagesë të tarifës së aplikimit”, do të ofrohen nga personeli i sekretarisë mësimore për plotësim/nënshkrim nga aplikanti, ditën e aplikimit.

DOKUMENTACIONI SHITESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE TË SHPALLUAR FITUES TË KONKURSIT

- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga përmbarimi

Të dhënat për rregulloren e konkursit, testeve gjenden në faqen zyrtare të AFA dhe të MM.

*Publikimi i listës së renditjes së aplikantëve fitues do të bëhet brenda datës **30 Gusht 2022**, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e aplikantëve.*